



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

Tiranë, më 25.09.2018

RAPORT

PËR

PROJEKTVENDIMIN

**“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË STRUKTURËN ORGANIZATIVE,
ORGANIKËN DHE KLASIFIKIMIN E PAGAVE TË PERSONELIT TË KOMISIONIT TË
PAVARUR TË KUALIFIKIMIT”**

- Hyrje

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në mbledhjen e datës 25 shtator 2018, në cilësinë e komisionit përgjegjës në përputhje me nenin 18 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” si dhe nenin 18 të Rregullores së Kuvendit, mori në shqyrtim kërkesën e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, drejtuar Kuvendit për miratimin e disa shtesave në organikën ekzistuese të këtij institucioni.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut caktoi relator për shqyrtimin e kësaj kërkeje deputetin Bashkim Fino. Në mbledhjen e Komisionit për të prezantuar dhe për të paraqitur argumente për projekt-strukturën organizative dhe organikën e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, ishin të pranishëm, znj. Genta Bungo, Kryetare e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe znj. Valbona Sanxhaktari, komisionere.

Komisioni përgjegjës për Çështjet Ligjore, kërkoi zyrtarisht mendimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe të Departamentit të Administratës Publike si institucione përgjegjëse, të cilat vlerësojnë përkatësisht kostot financiare në buxhetin e shtetit, që shoqërojnë miratimin e një strukture organizative si dhe hartimin e strukturës dhe klasave të pagave për punonjësit e administratës publike. Përfaqësuesit e këtyre institucioneve ishin të pranishëm edhe në mbledhjen e komisionit duke parashtruar qëndrimin e tyre.

I. Baza kushtetuese dhe ligjore për shqyrtimin e projekt-vendimit

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (këtu e më poshtë referuar si Komisioni), është pjesë e sistemit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, që ka për qëllim garantimin dhe funksionimin e

shtetit të së drejtës, sigurimin e pavarësisë së sistemit të drejtësisë, si edhe rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi. Komisioni ushtron funksionet e tij si institucion i pavarur dhe i paanshëm, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

Në përputhje me parashikimet kushtetuese dhe në zbatim të neneve 18 dhe 19 të ligjit nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni është konceptuar si institucion kushtetues i pavarur, që organizohet dhe funksionon si entitet juridik, me buxhet të veçantë të financuar nga buxheti i shtetit si dhe burime të tjera financiare të parashikuara nga ligji, me strukturë dhe personel profesional dhe administrativ.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në nenin C paragrafi i tretë i ka njohur anëtarëve të Komisionit statusin e anëtarit të Gjykatës së Lartë gjatë ushtrimit të mandatit të tyre.

Bazuar në parashikimet e nenit 18 pika 1 të ligjit 84/2016, sipas së cilës struktura organizative dhe klasifikimi i pagave për personelin e institucioneve të rivlerësimit miratohet nga Kuvendi, është miratuar vendimi 93/2017 “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”. Gjithsesj për institucionin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (KPK) **janë miratuar 50 punonjës.**

Konkretisht referuar vendimit të sipërcituar të Kuvendit struktura organike e KPK përbëhet nga: 12 komisionerët e emëruar me vendimin nr.82/2017 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë; Sekretari i Kryetarit (1); Njësia e Shërbimit Ligjor (16 këshilltarë prej të cilëve 12 këshilltarë juristë dhe 4 këshilltarë ekonomikë); Sekretari i Përgjithshëm (1); Drejtoria e Menaxhimit të Çështjeve dhe Marrëdhënieve me Median dhe Publikun (12); Drejtoria Ekonomike dhe e Shërbimeve Mbështetëse (8).

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit i është drejtuar Kuvendit të Shqipërisë, me kërkesën për shtesë personeli duke paraqitur argumentet përkatëse për secilin shtesë të kërkuar. Përkatësisht nga KPK është kërkuar: shtimi në Njësinë Ligjore të tetë këshilltarëve ekonomikë, 2 përkthyes shtesë, 2 specialistë shtesë protokoll/arkive, 2 specialist të sekretarisë gjyqësore, 1 specialist prokurimesh dhe një punonjës shtesë pastrimi.

Sipas nenit 78, pika 1 e Kushtetutës: *Kuvendi vendos me shumicën e votave, në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të tij, përveç rasteve kur Kushtetuta parashikon një shumicë të cilësuar.*

Nga analiza e dispozitave të mësipërme kushtetuese dhe ligjore dhe nga përmbajtja konkrete e propozimit, rezulton se miratimi nga Kuvendi i disa shtesave dhe ndryshimeve në projektstrukturën organizative, organikën dhe klasifikimit të pagave për personelin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i nënshtrohet rregullit të përgjithshëm për sa i përket shumicës.

II. Qëllimi dhe përmbajtja e projektvendimit

Nga studimi i propozimeve dhe i relacionit shoqërues, rezulton se Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, (këtu e më poshtë referuar si Komisioni), është pjesë e sistemit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, që ka për qëllim garantimin dhe funksionimin e shtetit të së drejtës, sigurimin e pavarësisë së sistemit të drejtësisë, si edhe rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi. Komisioni ushtron funksionet e tij si institucion i pavarur dhe i paanshëm, mbi bazën e

parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

Në përputhje me parashikimet kushtetuese dhe në zbatim të neneve 18 dhe 19 të ligjit nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni është konceptuar si institucion kushtetues i pavarur, që organizohet dhe funksionon si entitet juridik, me buxhet të veçantë të financuar nga buxheti i shtetit si dhe burime të tjera financiare të parashikuara nga ligji, me strukturë dhe personel profesional dhe administrativ.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në nenin C paragrafi i tretë i ka njohur anëtarëve të Komisionit statusin e anëtarit të Gjykatës së Lartë gjatë ushtrimit të mandatit të tyre. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit përbëhet nga katër trupa gjykues të përhershëm me tre anëtarë secili.

Në bazë të nenit 18 të ligjit nr. 84/2016 institucionet e rivlerësimit kanë personel dhe pajisjet e nevojshme për të përmbushur detyrat e ngarkuara nga ky ligj. Struktura organizative dhe klasifikimi i pagave për personelin e institucioneve të rivlerësimit miratohen nga Kuvendi me propozimin e institucionit përkatës.

Argumentet e KPK:

Në relacionin shoqërues, argumentohet se pas një viti pune ka dalë e nevojshme përforcimi i njësisë së shërbimit ligjor të KPK duke shtuar këshilltarët ekonomik me faktin që pas shpërndarjes së trupave gjykuese një këshilltarë ekonomik duhet të punonjë njëkohësisht me tre këshilltarë juristë dhe të mbulojë një volum pune tre herë më të madh. Sipas argumenteve të KPK një këshilltar ekonomik punon me 50 dosje.

Gjithashtu argumentohet shtesa e përkthyesve pasi lidhet me nevojën për kryerjen me kohë dhe cilësi të përkthimit të dosjeve, duke marrë në konsideratë që bazuar në parashikimet e nenit C, pika 15 të Kushtetutës, gjuhët zyrtare të Komisionit, të Kolegjit të Apelit dhe komisionerëve publikë janë gjuha shqipe dhe angleze.

Shtesat e tjera për një specialist prokurimesh; 2 specialistë arkiv/protokolli; 2 specialistë të sekretarisë gjyqësore dhe 1 punonjës pastrimi, argumentohen në funksion të përmirësimit dhe efienës së punës tërësore në funksion të rolit dhe detyrave të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Njëkohësisht përfaqësuesit e KPK gjatë shqyrtimit të projektvendimit në Komisionin e Ligjeve, kërkuar dhe unifikim të disa funksioneve me shtesa për vështirësi pune të tilla si në pozicionet e IT, protokoll/arkivë dhe punonjës mbështetës njësoj si ato që trajtohen për të gjithë administratën publike sipas vendimeve përkatëse të Këshillit të Ministrave.

Sipas kërkesave të paraqitura Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, propozon 16 punonjës shtesë.

III. Çështje të diskutuara gjatë shqyrtimit në komision

Gjatë shqyrtimit të projekt-vendimit në komision u parashtruan dhe u sqaruan një sërë çështjesh sa i përket strukturës së propozuar. Në këtë kuptim relatori paraqiti argumentet e detajuara për nevojën e

rishikimit të strukturës duke mbajtur në konsideratë kërkesat e propozuara, sidomos ato që lidhen me funksionet kryesore (njësia e shërbimit ligjor dhe përkthyes e specialist gjyqësor) për të përmbushur qëllimin e dyfishtë të ushtrimit të funksioneve në mënyrë të plotë e të pavarur, në konsideratë të rëndësisë që organi mbart dhe të efikasitë në mënyrën e funksionimit dhe organizimit, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 84/2016.

Diskutime pati edhe lidhur me shqetësimin për parashikimin e strukturës së KPK në VKM 187/2017 me qëllim përfshirjen e funksioneve me shtesa në vështirësi pune, unifikimin e kategorisë së pagave për specialistët gjyqësorë për të tre organet e rivlerësimit kalimtar apo lidhur me kostot financiare për t'u mbuluar menjëherë gjatë vitit 2018 bazuar në parashikimet e ligjit të buxhetit të shtetit për vitin 2018 dhe gjëndjes rezervë që mbart vet institucioni nga mospërdorimi i zërave të pagave për strukturat e parashikuara me fonde buxhetore por të parekrutuara gjatë vitit 2018, etj.

Sa më sipër, Komisioni u njoh me mendimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për koston buxhetore si dhe me mendimin e Departamentit të Administratës Publike, për të reflektuar shqetësimet lidhur me riklasifikimin e pagave të disa funksioneve.

DAP sqaroi se Ligji 84/2016 ka deleguar Kuvendin si organi kompetent që të kryejë jo vetëm ndryshimet strukturore në të tre institucionet e rivlerësimit kalimtar, por edhe të përcaktojë për këto institucione çështjet e lidhura me klasifikimin e pagës.

Deputetët e shumicës parlamentare në komision të pranishëm, u shprehën se organet duhet të mbështeteshin në kërkesat e tyre dhe të pajiseshin me të gjitha burimet e nevojshme financiare dhe njerëzore, për t'u siguruar funksionimin optimal të tyre.

Nga ana e relatorit, janë zhvilluar dy takime me përfaqësuesit e organeve të rivlerësimit, gjatë të cilave është diskutuar lidhur me nevojat e tyre për shtesa në organikë dhe argumentet përkatëse mbi të cilat mbështeten këto kërkesa.

Varianti i propozuar nga relatori, konsiston në rritje të numrit të punonjësve në strukturën e KPK me **14 punonjës** ku fuqizohet më tej Njësia e Shërbimit Ligjor me **8 këshilltarë** ekonomikë, përkthimi zyrtar me **dy përkthyes**, si dhe shtesa e **dy specialistëve gjyqësorë**, **një punonjësi arkiv-protokolli** dhe **një punonjës pastrimi**.

Nga ana e përfaqësuesit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit u mbajt qëndrimi se institucioni pas këtyre kërkesave të pranura, ishte dakort me propozimin final që relatori i propozonte komisionit.

Për sa i takon, kërkesës për shtimin e një specialist prokurimesh, relatori e vlerësoi të panevojshme këtë propozim duke marrë në konsideratë faktin se në institucione me një numër të ngjashëm punonjësish prokurimet janë të kufizuara në blerje të vogla me njësi prokurimi që funksionojnë rast pas rasti. Kjo kërkesë nuk u pranua as për dy institucionet e tjera të rivlerësimit, të cilat kanë kërkuar një specialist të dedikuar për prokurimet.

Për të siguruar uniformitetin e tre strukturave organizative, me propozim të relatorit, komisioni miratoi **riklasifikimin e pagave** për pozicionet specialist sekretarie, specialist protokoll-arkive, specialist redaktor gjuhësor dhe specialist pritje me popullin, duke riklasifikuar pozicionet e nivelit IV-b në IV-a si dhe kalimin në klasën III-b për pozicionet e klasës IV-a. Bazuar, në propozimin e

KPK të mbështetur nga relatori, u miratua edhe rikategorizimi i pozicionit të shoferit, në shofer/korrier i shoqëruar edhe me riklasifikim të klasës së pagës nga V në klasën VI.

Kërkesa e paraqitur gjatë shqyrtimit në komision të këtij projektvendimi, për përcaktimin e shtesës për vështirësi punë të punonjësve të informatikës (kërkesë e paraqitur edhe nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit) si dhe të punonjësve mbështetës, në vendimin përkatës të Kuvendit, shtesë e cila përfitohet aktualisht nga punonjësit e tjerë të institucioneve buxhetore, sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave, u mbështet nga relatori dhe Komisioni.

Për rrjedhojë, me qëllim sigurimin e barazisë në pagesë për funksione të njëjta, në vendimin përkatës të Kuvendit do të përcaktohen për të tre institucionet e rivlerësimit, referimi në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e punonjësve të administratës së shtetërore dhe të disa institucioneve të tjera të pavaruara, lidhur me përfitimin e shtesave për kushte me natyrë të vështirë/dëmshme për pozicionet e:

- specialistit të informatikës dhe specialistit të arkivës; dhe
- punonjësit mbështetës sipas vendimit përkatës të KM për pagat e punonjësve mbështetës buxhetore.

Në tërësi nga shtesa prej 16 punonjësish e kërkuar nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, nga ana e Komisionit të Ligjeve u miratuan 14 punonjës shtesë si dhe u miratua riklasifikimi i pagës për disa pozicione.

Në total numri i punonjësve për Komisionin e Pavarur të Kualifikimit shkon në **64 punonjës** nga 50 punonjës që ka aktualisht ky institucion.

Në përfundim Komisioni vlerësoi që projektvendimet e Kuvendit për shtesa dhe ndryshime në strukturën organizative dhe nivelin e pagave të institucioneve të rivlerësimit kalimtar të fillojnë efektet me miratimin e tyre në seancë plenare, kjo pasi institucionet e rivlerësimit u shprehën se me fondet që kanë në dispozicion për vitin 2018 mund të përballojnë efektet financiare të këtyre shtesave në strukturë si dhe riklasifikimit të pagave.

IV. PËRFUNDIMI

Në përfundim të procesit të shqyrtimit dhe diskutimit të këtij projektvendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, miratoi projektvendimin “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 93/2017 “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit” dhe ia paraqet seancës plenare të Kuvendit për votim, sipas tekstit bashkëlidhur këtij raporti.

RELATOR

Bashkim FINO

KRYETARI

Ulsi MANJA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

PROJEKT - VENDIM

Nr. ____/2018

“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 93/2017 “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS ORGANIZATIVE, ORGANIKËS DHE KLASIFIKIMIT TË PAGAVE TË PERSONELIT TË KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT”

Në mbështetje të nenit 78 dhe nenit C të Kushtetutës si dhe të nenit 18, pika 1 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Lidhja nr. 1 “Organika dhe klasifikimi i pagave të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit” e vendimit nr. 93/2017 ndryshohet sipas lidhjes nr. 1 “Organika dhe klasifikimi i pagave të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit” që është pjesë përbërëse dhe i bashkëlidhet këtij vendimi.

II. Lidhja nr. 2, “Struktura organizative e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”, e vendimit nr. 93/2017 ndryshohet sipas lidhjes nr. 2 “Struktura organizative e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit” që është pjesë përbërëse dhe i bashkëlidhet këtij vendimi.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Gramoz RUÇI

ORGANIKA DHE KLASIFIKIMI I PAGAVE TË KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT

FUNKSIONI ORGANIK	Klasifikimi i pagës	Numri (2)
I. KRYETAR	G3*	1
Sekretar	Sekretar në kabinetin e kryetarit të Kuvendit**	1
II. KOMISIONERËT	G3*	(11)
III. NJËSIA E SHËRBIMIT LIGJOR		(24)
Këshilltarë juristë	80% e pagës G3*	12
Këshilltarë ekonomistë	80% e pagës G3*	12
IV. SEKRETAR I PËRGJITHSHËM	I-a	1
V. DREJTORIA E MENAXHIMIT TË ÇËSHTJEVE DHE MARRËDHËNIEVE ME MEDIAN DHE PUBLIKUN		(16)
Drejtor	II-b	1
Specialist sekretarie gjyqësore	III-b	6
Specialist për zbardhjen dhe redaktimin e vendimeve	IV-a	2
Përkthyes	II-b	5
Koordinator për median dhe marrëdhëniet me jashtë	III-a	1
Specialist pritje me popullin	IV-a	1
VI. DREJTORIA EKONOMIKE DHE E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE		(10)
Drejtor	II-b	1
Specialist financë/buxhet	III-b	1
Specialist i burimeve njerëzore	III-b	1
Specialist IT ***	III-b	1
Specialist protokoll/arkivë ****	IV-a	2
Magaziniere	VII	1
Punonjës pastrimi	III	2
Shofer/ Korrier	VI	1
Total		64

Shënim:

*Sipas ligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

**Kategoria e pagës për sekretarin e Kryetarit, është sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e nëpunësve civilë në administratën shtetërore dhe institucione të tjera të pavarura.

*** Punonjësit në pozicionin e specialistëve të teknologjisë së informacionit përfitojnë shtesën për natyrë të veçantë pune në masën dhe sipas kushteve të përcaktuara në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e nëpunësve civilë në administratën shtetërore dhe institucione të tjera të pavarura.

**** Punonjësit në pozicionet specialist arkivi, përfitojnë shtesë për kushte të vështira e të dëmshme për shëndetin sipas kushteve dhe masës së përcaktuar në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e nëpunësve civilë në administratën shtetërore dhe institucione të tjera të pavarura.

***** Përfitimet për kushte të vështira e të dëmshme të shëndetit për punonjësit mbështetës janë sipas përcaktimeve në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore.

Strukturë organizative e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

